

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 645 Prot.

Tiranë, më 10.052017

VENDIM Nr. 84, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të projektit "*Objekt banimi dhe shërbimesh 6 kat + 1 kat nëntokë*" me vendndodhje në rrugën "*Stefan Kaçulini*", zona arkeologjike "B", Durrës-subjekti "Drejtoria e Përgjithëshme e Entit Kombëtar të Banesave" sh.a.,

VENDOSI:

1. Të kryhet nga DRKK Durrës një sondazh brenda sheshit të ndërtimit.
2. ASHA të verifikojë raportet e terrenit, të depozituar pranë saj nga DRKK Durrës, e cila do të kryejë këtë sondazh.
3. Rezultatet e sondazhit arkeologjik të paraqiten në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë dhe procedura e shqyrtimit dhe vendimarrjes do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të këtij Këshilli.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

